

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ilirjan Celibashi kërcënon me mesazhe gazetaren Desada Metaj, reagon AGSH
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/ilirjan-celibashi-kercenon-me-mesazhe-gazetaren-desada-metaj-reagon-agsh-i586887
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:10:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9ea6c7c1402f54674d2c353fc88bc7ddcf96b2dba7d2e7c51f7078a78f4fbda
TEKSTI	c0ecad75596f1bac2414de52bdf3d05527c9ec82766fc6f73085665239ed4f3d
PAMJA	8feb16e47273ac9f5eb9c39273f674d61f64d8bcf38d7ccf1a9b5335484c64f4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2c233d38f7a2e11f0b2596be662eb29089bfa227ff6de36f6a1a06d1f3e42198
E MËPARSHMJA	414ff2a3ca7b5b49ab5d62348e2b8f6dd8f885053acde9abb126caf3b137a784
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2c233d38f7a2e11f0b2596be662eb29089bfa227ff6de36f6a1a06d1f3e42198>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le [Krizja energjetike, Macron thetret G7: Diskutohet çlirimi i rezervave strategjike](#) [Homazh per regjisorin e madh italian Luchino Visconti ne edicionin e 24-t te TITF](#) [Hoxha t fundit](#)

Ilirjan Celibashi kërcënon me mesazhe gazetaren Desada Metaj, reagon AGSH



18 Shtator 2026, 15:06Sociale TEMA



DEKLARATË

Desada Metaj
12 minuta ·

Reagim i detyruar...

Dje VNA publikoi dy shkrime investigative lidhur me një tender në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Të dy shkrimet janë mbështetur në dokumente dhe në të dhëna zyrtare, të verifikueshme.

Pas publikimit, jam kontaktuar personalisht nga kryetari i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, lidhur me këto shkrime. I kam bërë të qartë se VNA është e gatshme të publikojë çdo sqarim zyrtar të KQZ-së për procedurat e tenderit, për aq kohë sa ai sqarim vjen institucionalisht dhe lidhet me faktet e publikuara.

Një sqarim i tillë nuk erdhi.

Në vend të tij, sot kam mësuar se z. Celibashi ka thirrur në zyrë subjektin që nuk ka fituar tenderin. Pas këtij takimi, pronari i këtij subjekti, Granit Gjani, më ka telefonuar për të më thënë se z. Celibashi i kishte kërkuar të më kontaktonte, me qëllim që unë të mos merresha më me të.

Dua të sqaroj publikisht se nuk e njoh z. Granit Gjani dhe se ai nuk është personi që është ankuar në VNA për problematikën e tenderave në KQZ.

Ndërkohë, z. Celibashi më ka dërguar mesazhe dhe më ka telefonuar me një gjuhë që, për mendimin tim, nuk i shkon një zyrtari të lartë shtetëror, aq më pak drejtuesit të institucionit që administrojnë zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë.

E siguroj z. Celibashi se nuk më intimidon as me gjuhë juridike, as me presione politike, as me telefonata jashtë çdo standardi institucional.

Nëse z. Celibashi mendon se ka një problem me shkrimet e VNA-së, ruga është shumë e thjeshtë: të dërgojë një sqarim zyrtar, të paraqesë dokumente, ose t'u drejtohet institucioneve të drejtësisë. Për çdo rast, mesazhet dhe telefonatat me të mund t'i vë në dispozicion të drejtësisë.

Me drejtësinë, z. Celibashi ka më shumë afri profesionale.

Unë, ndërkohë, do të vazhdoj t'i qëndroj besnike të vërtetës dhe dokumenteve. **Shiko më pak**

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë ka reaguar pas një statusi të gazetares Desada Metaj, e cila përmes një postimi në rrjetet sociale ka bërë me dije se ka marrë mesazhe intimiduese nga kreu i KQZ, Ilirjan Celibashi.

Kjo për arsye se Metaj ka publikuar në portalin VNA disa shkrimi investiguese për tenderat e dyshmitë që Celibashi ka kryer si titullar i Institucionit.

Pas këtyre pretendimeve AGSH ka reaguar në mbështetje të gazetares Desada Metaj ku shkruan:

"Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë është njohur me pretendimet e gazetares Desada Metaj, sipas së cilës, pas publikimit nga VNA të dy shkrimeve investigative mbi një procedurë tenderimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ajo është përballur me telefonata dhe mesazhe nga kreu i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, si dhe me një përpjekje për ta kontaktuar përmes një subjekti të përfshirë në tender.

Çdo zyrtar publik ka të drejtën të kundërshtojë një raportim, të paraqesë dokumente dhe të kërkojë korrigjimin e pasaktësive. Megjithatë, komunikimi duhet të jetë institucional, transparent dhe pa gjuhë apo veprime që mund të perceptohen si presion ndaj gazetarëve. Përpjekja për të ndikuar nëpërmjet personave të tretë, është e papranueshme dhe cenon rëndë pavarësinë editoriale.

AGSH i kërkon z. Celibashi dhe KQZ-së të japin një sqarim publik mbi pretendimet e ngritura dhe t'i përgjigjen raportimit me fakte e dokumente zyrtare. Institucionet publike kanë detyrimin të garantojnë transparencë, llogaridhënie dhe respekt për punën e medias, veçanërisht kur bëhet fjalë për përdorimin e fondeve publike”, thekson në njoftim AGSH.

STATUSI I DESADA METAJ

Reagim i detyruar...

Dje VNA publikoi dy shkrime investigative lidhur me një tender në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Të dy shkrimet janë mbështetur në dokumente dhe në të dhëna zyrtare, të verifikueshme.

Pas publikimit, jam kontaktuar personalisht nga kryetari i KQZ-së, z. Ilirjan Celibashi, lidhur me këto shkrime. I kam bërë të qartë se VNA është e gatshme të publikojë çdo sqarim zyrtar të KQZ-së për procedurat e tenderit, për aq kohë sa ai sqarim vjen institucionalisht dhe lidhet me faktet e publikuara. Një sqarim i tillë nuk erdhi.

Në vend të tij, sot kam mësuar se z. Celibashi ka thirrur në zyrë subjektin që nuk ka fituar tenderin. Pas këtij takimi, pronari i këtij subjekti, Granit Gjana, më ka telefonuar për të më thënë se z. Celibashi i kishte kërkuar të më kontaktonte, me qëllim që unë të mos merresha më me të.

Dua të sqaroj publikisht se nuk e njoh z. Granit Gjana dhe se ai nuk është personi që është ankuar në VNA për problematikën e tenderave në KQZ.

Ndërkohë, z. Celibashi më ka dërguar mesazhe dhe më ka telefonuar me një gjuhë që, për mendimin tim, nuk i shkon një zyrtari të lartë shtetëror, aq më pak drejtuesit të institucionit që administron zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë.

E siguroj z. Celibashi se nuk më intimidon as me gjuhë juridike, as me presione politike, as me telefonata jashtë çdo standardi institucional.

Nëse z. Celibashi mendon se ka një problem me shkrimet e VNA-së, rruga është shumë e thjeshtë: të dërgojë një sqarim zyrtar, të paraqesë dokumente, ose t'u drejtohet institucioneve të drejtësisë. Për çdo rast, mesazhet dhe telefonatat me të mund t'i vë në dispozicion të drejtësisë.

Me drejtësinë, z. Celibashi ka më shumë afri profesionale.

Unë, ndërkohë, do të vazhdoj t'i qëndroj besnike të vërtetës dhe dokumenteve.

7 Komente



pjeter

18 Shtator 2026, 15:28

Qe mund te perceptohen??? E Atehere?? Eshte problemi juaj se perceptoni - interpretoni ashtu?? Gazetaret kane rol fisnik, por varet si e perdor funksionin, ne Shqiperi, gazetaria ka nje nivel shune td ulet profesional, dhe shume shpesh levis ne kufijte e kriminalitetit. Qe ky shkrim te jete korrekt me lexuesit duhet te kete ate se per cfare ka reaguat Celibashi, detaje te sakta ose gjithe shkrimin nen thonjeza te gazetares ne fjale, qe te kuptojme edhe ne, dhe te krijojme nje opinion se Celibashi ka reaguat i provokuar rende apo jo, apo shkrimi i gazetares nuk u permbahet fakteve por vetem ide tendenziose. Gjithcka mund te jete ,, qe Celibashi te kete abuzuar me fondet, por po nuk publikuat shkrimin e kompletuar, edhe faktin qe bashkesia e Gazetareve shqiptare, kategoria e tyre , gezon ne mbare Shqiperine opinionin e gazetaresve gjobaxhinj, qendron ne te njejtin nivel me pretendimet e Gazetares ne fjale.

[Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0



Landi

18 Shtator 2026, 15:44

Opo seshte trim ky qilibashi! Ne vendin e gabuar dhe ne kohe te pershtateshme per tenderat ,qili....bash!

[Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Vlonjati

18 Shtator 2026, 15:59

Nje pjes e juaja te gazetaresve jeni bere si republike me vehte.Jo per rastin ,po nje gje tu adresohet te hidheni per fytin.Po cfar jeni ju te pagabushem . Po kur jepni lajme te pa verifikuara aq me keq shpifje pse nuk flisni ju shoqata e gazetaresve.apo ne ke te bote vetem ju jeni te pagabushem.Le oastaj te flasim per nivelin profesional.Eshte mire qe te mereni edhe me vehten

[Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 1



"Intimiduesi" paqesor.

18 Shtator 2026, 16:10

Sa shpejt qe intimidoheni, mor jahu! MOs se na e keputet shpirtin me keto qurravitje! E kush ju kercenon, Pa! Celibashi! "O Turp! Ku e ke skuqjen"?

[Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0



Agron

18 Shtator 2026, 16:18

Jepi desada se ke dhe përkrahjen e Besnik Mustafait

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0



poliretan

18 Shtator 2026, 16:25

E hangu dhe likja i vogel do kete bere ndonje zullumn e duan tja fusin. E paska ngerne karremin koqja.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Xha

18 Shtator 2026, 16:26

Kush ishte kërcënimi?

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Deputeti i PS, humb bashkëshorten: Mesazhi prekës i tij...](#)

14:19 Sociale / 2 komente

[FOTO/ Rama vizite ne Malin Athos, kaion naten ne nje nga manastiret me te njohura ortodokse](#)

20:57 Sociale / 39 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.